

BE-ja për një ekonomi qarkulluese dhe rritje të gjelbër: mbështetje për tranzicionin e Shqipërisë drejt një ekonomie qarkulluese**Duration:** 01.10.2023 - 31.05.2027**Countries:**
Albania**EU contribution:** € 10 600 000**Total budget:** € 14 600 000**Implementer:**

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ)

**Funded by the
European Union****Project description:**

Projekti "BE-ja për një ekonomi qarkulluese dhe rritje të gjelbër: mbështetje për tranzicionin e Shqipërisë drejt një ekonomie qarkulluese" nxit kalimin e Shqipërisë drejt një ekonomie të gjelbër, efektive në burime, të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe konkurruese.

Projekti zbatohet nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) në partneritet me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe përmirëson kuadrin rregullator, kapacitetet institucionale dhe kushtet e tregut të nevojshme për tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese.

Projekti fokusohet në harmonizimin e legjislacionit të menaxhimit të mbetjeve me kuadrin ligjor të BE-së (acquis-in e BE-së), vendosjen e sistemeve të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (EPR), përf forcimin e kapaciteteve zbatuese dhe promovimin e modeleve të prodhimit dhe konsumit të qëndrueshëm.

Në nivel vendor, projekti mbështet bashkitë në zbatimin e masave të menaxhimit të mbetjeve sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese, si qendrat e kompostimit dhe objektet e rikuperimit të materialeve. Paralelisht, nxit inovacionin e gjelbër nëpërmjet skemave të mbështetjes së biznesit, një inkubatori të gjelbër dhe mekanizmeve të financimit të vogël që synojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet kërkimore.

Duke gërshetuar reformën e politikave, forcimin institucional dhe zhvillimin e sektorit privat, projekti kontribuon në

Expected results:

- □kuadër rregullator i përmirësuar dhe i harmonizuar me BE-në për menaxhimin e mbetjeve dhe ekonominë qarkulluese;
- □kapacitete të konsoliduara të autoriteteve kombëtare dhe vendore për zbatim dhe monitorim efektiv të legjislacionit;
- □sisteme funksionale të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (EPR) për kategoritë e zgjedhura të mbetjeve speciale;
- □iniciativa të ekonomisë qarkulluese të zbatuara në bashkitë partnere;
- □rritje e mëtejshme e modeleve inovative të biznesit të gjelbër që përfshijnë perspektivën gjinore dhe krijimin e vendeve të punës së gjelbër.